

Rekomandimet e pjesëmarrësve të Paneleve Qytetare për çështjet e aftësisë së kufizuar

KONTEKSTI

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), së bashku me Involve UK, ka zbatuar metodologjinë deliberative të “*Paneleve Qytetare: Një mënyrë e re për t’u angazhuar në proceset Parlamentare*” përmes një aktiviteti tre ditor në Tiranë gjatë datave 17-19 tetor. Panelet Qytetare njihen si një praktikë e mirë ndërkombëtare që mundëson krijimin e një hapësire për diskutimin në mënyrë të informuar të çështjeve që janë në axhendën parlamentare, si dhe kontribuojnë në forcimin e transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në aktivitetin legjislativ dhe mbikëqyrës të parlamentit.

Rreth 50 qytetarë të përzgjedhur rastësisht nga i gjithë vendi u informuan në mënyrë objektive nga ekspertë të çështjeve të personave me aftësi të kufizuara dhe më pas formuluan rekomandimet për këtë çështje. Përgjatë tre ditëve, më shumë se 10 ekspertë të fushës dhe moderatorë me përvojë lehtësuan diskutimet e qytetarëve pjesëmarrës në Panelet Qytetare. Diskutimet u fokusuan në: aksesueshmërinë dhe shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, edukimin dhe punësimin gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike duke i dhënë mundësinë qytetarëve pjesëmarrës të angazhoheshin në një proces të thelluar dhe informuar konsultimi. Në përfundim, qytetarët pjesëmarrës formuluan një listë prej 10 prioritetesh dhe rekomandimet përkatëse me qëllim bashkë-formimin e politikave mbështetëse për PAK. Rekomandimet e propozuara evidentojnë kërkesat bazë për pjesëmarrje, përfaqësim dhe përfshirje, duke kërkuar që personat me aftësi të kufizuara të marrin një rol aktiv në formësimin e kushteve të jetës së tyre.

Kjo nismë është në kuadër të projektit “Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve”, zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Instituti Shqiptar i Shkencës dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike.

REKOMANDIMI 1: GARANTIMI I INFRASTRUKTURËS DHE BURIMEVE NJERËZORE PËR FËMIJËT PAK NË ÇDO INSTITUCION ARSIMOR PËR NJË PJESËMARRJE GJITHËPËRFSHIRËSE TË NXËNËSVE ME PAK NË PROCESIN MËSIMOR DHE ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE EKSTRA-KURRIKULARE.

Përmirësimi në vazhdimësi i Ligjit ‘Për Sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ka mundësuar që nxënësit me aftësi të kufizuara të mund të mësojnë jo vetëm në shkolla speciale, por bashkë me moshatarët në shkolla të përgjithshme, duke planifikuar masa mbështetëse në procesin mësimor.

Problematika të evidentuara

- Mungesë të infrastrukturës (klasa burimore dhe mjete didaktike)
- Mungesa e mësuesit me profil që i përgjigjet nevojave specifike të nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Ndërveprim i pamjaftueshëm prindër - mësues ndihmës

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren:

- Çdo institucion arsimor (kopsht, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme) duhet të ketë klasë burimore e cila plotëson kushtet për të akomoduar nevojat edukative të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë.
- Klasat burimore të jenë të pajisura me mjete didaktike, teknologji asistive dhe mjete të tjera që ndihmojnë zhvillimin tërësor.
- Zyra Vendore e Arsimit / ZVA duhet të bashkërendojë punën që Komisioni i Vlerësimit të ushtrojë aktivitetin e tij para fillimit të vitit akademik, ndihmon institucionet arsimore (kopshtet dhe shkollat) të planifikojnë burimet njerëzore dhe materialet e nevojshme për çdo fëmijë me AK.
- Përfaqësues të prindërve/kujdestarëve ligjore të fëmijës me aftësi të kufizuara duhet të jenë të përfshirë në vlerësimin nga Komisioni i Vlerësimit në ZVA si dhe të jenë pjesë në hartimin e Planit Edukativ Individual i cili hartohet nga komisioni shkollor (mësues ndihmës, mësuesi i klasës, psikologu shkollor dhe prindi).

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Financave
- Bashkitë
- DRAP / ZVA / Drejtorët e shkollave
- Komuniteti i prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara
- OJF të personave me aftësi të kufizuara

REKOMANDIMI 2: ZGJERIMI I SHËRBIMIT ARSIMOR NË MBËSHTETJE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Ligji ‘Për Sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar, si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij ka mundësuar që nxënësit me aftësi të kufizuara të mund të mësojnë jo vetëm në shkolla speciale, por bashkë me moshatarët në shkolla të përgjithshme, duke planifikuar masa mbështetëse në procesin mësimor.

Problematika të evidentuara

- Mungon vlerësimi për nevojat e veçanta sipas tipologjisë së nxënësve me aftësi të kufizuara

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Zgjerimi dhe trajnimi i stafit mësimor për të punuar me personat me aftësi të kufizuara. Mësuesit të zhvillojnë besimin dhe njohuritë për të ndihmuar fëmijët e përjashtuar, të jenë të motivuar për të identifikuar dhe ndihmuar nxënësit që kanë vështirësi; trajnimet profesionale duhet të përfshijnë pedagogji dhe teknika të mësimdhënies gjithëpërfshirëse; hartimin e planeve individuale; përfshirja e prindërve; përdorimi i mjeteve dhe teknologjisë ndihmëse etj.
- Sipas nevojave që identifikohen dhe, në varësi të llojit të aftësisë së kufizuar, të garantohet pajisja me materiale të përshtatshme dhe me teknologji asistive në mbështetje të personave me aftësi të kufizuara.
- Të krijohen klasa burimore me qëllim mbështetjen dhe progresin akademik, personal dhe social të personave me aftësi të kufizuara (ose zhvillimin tërësor të çdo fëmije).
- Planifikim buxhetesh në nivel qendror dhe vendor

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Ministria e Financave.
- Instituti i Nxënësve që nuk Dëgjojnë.
- Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë.
- Bashkitë.
- Organizata ndërkombëtare që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

REKOMANDIMI 3: MËSUES LËVIZËS NË MBËSHTETJE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SITUATË GJAKMARRJEJE DHE NË ZONA TË THELLA.

Ligji 69/ 2012 Për Sistemin arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, si edhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Udhëzim nr. 26, datë 25.11.2019 për “Kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” sanksionohet detyrimi për masa për edukim jashtë shkollës.

Problematika të evidentuara

- Mungojnë alternativat për mësim jashtë shkolle për nxënësit me aftësi të kufizuara dhe për nxënësit në situatë gjakmarrjeje dhe në zona të thella.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Të vlerësohen nevojat për shërbimin "mësues lëvizës" dhe të hartohet një projektbuxhet për përmbushjen e nevojave.
- Të trajnohet stafi mësimor për ofrimin e shërbimit mësimor në shtëpi.
- Të monitorohet ofrimi i shërbimit në kohë dhe të përdoren rezultatet për përmirësimin e shërbimit.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar / DRAP dhe Zyrat Vendore të Arsimit/ ZVA
- Pushteti vendor / bashkitë
- OJF-të e personave me aftësi të kufizuara
- Komiteti i Pajtimin të Gjaveve.
- Avokati i Popullit.
- Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

REKOMANDIMI 4: RISHIKIMI I KOMISIONEVE SHUMË-DISCIPLINORE TË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR (NË VIJIM KVSHAK) DHE PAGËS PËR SHOQËRUESIT E PAK.

Në Ligjin 57/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij përcaktohet procedura e vlerësimit dhe masa e pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe ndihmësve personalë të tyre.

Problematika të evidentuara

- Nivel i ulët pagesës për Personat me Aftësi të Kufizuara
- Nivel i ulët i pagesës të shoqëruesve të Personave me Aftësi të Kufizuara
- Mosnjohje si periudhë punësimi e shoqëruesve të të gjitha kategorive të PAK

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren:

- Ndryshime ligjore:
 - për rritjen e pagesës së përcaktuar në KMCAP dhe KVSHAK për Personat me Aftësi të Kufizuara
 - për rritjen e pagesës së ndihmesave personale të Personave me Aftësi të Kufizuara.
- njohje e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë ndihmësat personale të Personave me Aftësi të Kufizuara

Aktorët përgjegjës

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave
- Komisioni mjekësor për përcaktimin e aftësisë për punë, KMCAP
- Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar
- Instituti i sigurimeve Shoqërore
- Shërbimi Social Shtetëror

REKOMANDIMI 5: RISHIKIMI I CIKLIT TË VLERËSIMIT I PERSONAVE ME AK TË KATEGORISË SË RËNDË (TETRAPLEGJIK + PROBLEME TË RËNDA MENDORE ETJ,)

Problematika të evidentuara

- Paraqitja në periudha të shpeshta kohore për vlerësim kërkon shumë shpenzime financiare për familjen e personit me Aftësi të Kufizuara:
- Kërkon transportin e dedikuar deri te Komisioni rajonal, qendror;
- Kërkon kushte higjienike specifike.
- Persona të tillë bëjnë rezistencë për të dalë nga shtëpia (sidomos me probleme të shëndetit mendor).
- Familjarët duhet të shkëputen nga puna për shoqërimin e tyre. Nganjëherë nuk mjafton vetëm një shoqërues.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Vlerësimi mjekësor i PAK, tetraplegjik + me probleme të rënda të shëndetit mendor, të vlerësohen me status të përhershëm, ose me afat të gjatë kohor rivlerësimi.
- Në raste të veçanta të mundësohet ambulanca me staf mjekësor mbështetës për lëvizjen e të sëmurit për t'u paraqitur për rivlerësim.
- Ndryshimi i rregullores së organizimit dhe funksionimit të KMCAP
- Ndryshimi VKM nr. 162/2020 “Për përcaktimin e masës, kushteve, procedurave + dokumentacionin për vlerësim të aftësisë së kufizuar.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Shërbimi Social Shtetëror;

REKOMANDIMI 6: KRIJIMI I QENDRAVE REHABILITUESE MULTIFUNKSIONALE PËR PERSONAT ME DËMTIME FIZIKE.

Ligji “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore” parashikojnë shërbime shoqërore.

Problematika të evidentuara

- Mungojnë qendrat rehabilituese multifunksionale për personat me dëmtime fizike të shkaktuara nga kushte dhe rrethana të ndryshme si p.sh. sëmundje, aksidente, etj. Ngritja dhe funksionimi i tyre është një masë urgjente e cila do të ndihmonte në lehtësimin dhe përmirësimin e jetës dhe shëndetit e një numri të konsiderueshëm njerëzish, etj.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Përfshirja në legjislacion e detyrimit për ngritjen e qendrave rehabilituese multifunksionale.
- Përgatitja e një Plani Veprimi ku të përcaktohen funksionimi i qendrave, buxheti për krijimin dhe administrimin e qendrave për infrastrukturën, logjistikën dhe burimet njerëzore në funksion të qendrave.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Financave,
- Ministria e Pushtetit Vendor.
- Komisioni Parlamentar për shëndetësinë dhe çështjet sociale.
- Bashkitë
- Shërbimi Social Shtetëror

REKOMANDIMI 7: ZGJERIMI I SKEMËS SE MBËSHTETJES SOCIALE PËR FAMILJET ME FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA TË RËNDA DHE KRIJIMI I QENDRAVE TË DEDIKUARA DITORE PËR TË PËRMIRËSUAR MIRËQENIEN FAMILJARE DHE INTEGRIMIN SHOQËROR. NGRITJA E SHËRBIMIT PËR JETESËN E PAVARUR.

Ligji “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Ligji “Për Vetëqeverisjen Vendore” parashikojnë shërbime shoqërore dhe ndërtimin e qendrave. Ligji “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara” sanksionon ngritjen e shërbimeve të jetesës së pavarur.

Problematika të evidentuara

- Janë të pamjaftueshme shërbimet për kategorinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara të rënda si dhe për PAK, kërkues për jetesën e pavarur.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Të zgjerohet skema e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore për të gjitha kategoritë e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Caktimi i një ndihmësi dytësor për kategorinë e Personave me Aftësi të Kufizuara të nivelit të rëndë e të thelluar.
- Krijimi i Qendrave ditore komunitare që ofrojnë shërbim për fëmijët me Aftësi të Kufizuar të rëndë.
- Krijimin e shërbimit për jetesën e pavarur për Personat e rritur me Aftësi të Kufizuara.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Ministria e Financave;
- Shërbimi Social Shtetëror
- Njësitë Vendore./ Bashkitë

REKOMANDIMI 8: PLOTËSIME NË LEGJISLACIONIN PËR PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Përmirësimi i legjislacionit të ri të punësimit ka fokus të veçantë edhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara duke hapur rrugë programeve e masave të reja për të nxitur punësimin e tyre.

Ligji “ Për nxitjen e Punësimit “ krijon Fondin Social të Punësimit (FSP) të dedikuar për aftësinë e kufizuar, i cili shërben për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Ky fond përdoret vetëm për financimin e projekteve që synojnë punësimin; vetëpunësimin; rehabilitim për punë; aftësimin dhe riaftësimin profesional; orientimin dhe këshillimin për punësim; shërbime mbështetëse; përshtatjen e vendit të punës për persona me aftësi të kufizuara, përfshirë personat që nuk dëgjojnë dhe invalidët e punës të vlerësuar pjesërisht të aftë për punë nga komisionet përkatëse; programe riintegrimi social; mbështetjen për nxitjen e punësimit të familjarëve të personave me aftësi të kufizuar.

Problematika të evidentuara

- Nevoja për plotësimin e legjislacionit të punësimit për një zbatim real të tij për punëkërkuesit me aftësi të kufizuara.
- Masa të pamjaftueshme për të detyruar punëdhënësit që të zbatojnë ligjin për të punësuar PAK dhe për të siguruar vazhdimësinë e punësimit të tyre.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Plotësimi me aktet nënligjore në lidhje me sanksionet për punëdhënësit që nuk zbatojnë detyrimet për punësimin e tyre;
- Vendosja në legjislacion e incentivave për punëdhënësit që punësojnë Personat me Aftësi të Kufizuara për të siguruar një proces punësimi të qëndrueshëm për ta.
- Zbatimi i detyrimit ligjor për përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara në kurset profesionale të administruara nga AKPA dhe institucione të tjera.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Ministria e Financave
- Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
- Bashkitë

REKOMANDIMI 9: PËRMIRËSIMI I PJESËMARRJES NË JETËN PUBLIKE DHE POLITIKE.

Kodi Zgjedhor dhe Udhëzime në zbatim të tij kanë mundësuar akses më të gjerë për pjesëmarrje të votuesve me aftësi të kufizuara në procesin e votimit në qendrat e votimit.

Problematika të evidentuara

- Ende nuk garantohet e drejta e votës për të gjithë zgjedhësit me aftësi të kufizuara.
- Akses i pamjaftueshëm fizik dhe në komunikim në qendrat e votimit

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Të ndërmerren masa lehtësuese në sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme fizike dhe logjistike nga ana e KQZ për garantimin e të drejtës së votës së personave me aftësi të kufizuara pranë qendrave të votimit.
- I gjithë informacioni zgjedhor të jetë edhe në formatin e thjeshtë për t'u kuptuar nga zgjedhësit me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psiko-sociale.
- Domosdoshmëria e ndryshimeve ligjore për të siguruar votim për personat me aftësi të kufizuara që e kanë të pamundur lëvizjen për në qendrat e votimit. Kjo nëpërmjet alternativave;
 - a. Votim nëpërmjet kutisë lëvizëse
 - b. Votim elektronik
 - c. Votim me postë

Aktorët përgjegjës:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
- Parlamenti për ndryshimet ligjore
- Pushteti vendor

REKOMANDIMI 10: KUOTA PËR RITJEN E PËRFAQËSIMIT POLITIK TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR.

Problematika të evidentuara

Edhe pse në Shqipëri janë rreth 160 mijë persona me aftësi të kufizuara, përfaqësues direkt të tyre në parlament nuk ka dhe, në këshillat vendore është një numër shumë i vogël përfaqësues të zgjedhur.

- Kjo ndikon negativisht në efikasitetin e hartimit të ligjeve
- Kjo ndikon në forcimin e demokracisë në vend dhe bërjen e institucioneve më gjithëpërfshirëse dhe të hapura.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Parashikimi ligjor për përfshirjen e kuotave për pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në jetën politike e publike.
- Zbatimi i detyrueshëm nga ana e KQZ-së, siç është rasti i përfshirjes gjinore.
- Zbatimi i ligjit nga ana e forcave politike.

Aktorët përgjegjës:

- Komisioni Parlamentar i Ligjeve. / Kuvendi i Shqipërisë.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
- Partitë Politike.

REKOMANDIMI 11: REALIZIMI I NJË MJEDISI TË AKSESUESHËM PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.

Ligjet e miratuara ose ato që po ndryshohen vitet e fundit sanksionojnë detyrimin që të gjitha ndërtime të reja dhe ndërtime ekzistuese që rikonstruktohen të jenë të pajisura me të gjitha elementet e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Detyrimet janë sanksionuar në Ligji kuadër me Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” dhe VKM-të në zbatim të tij, Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Ligji Nr. 10221 datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë.

Problematika të evidentuara

- Mjedisi infrastrukturor ka ende shumë barriera për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe shikim.
- Ende vazhdojnë të projektohen e ndërtohen objekte të reja që nuk përmbushin normat ndërtimore të aksesueshmërisë.
- Nuk respektohen standardet ndërtimore edhe kur vendosen elementet e përshtatshmërisë.
- Strukturat e kontrollit dhe miratimit të projekteve dhe të kontrollit të zbatimit të objekteve nuk kanë vëmendjen e duhur për vlerësimin e nivelit të zbatimit të legjislacionit për aksesueshmërisë në objekte.

Rekomandimi / Veprimet që duhet të ndërmerren

- Domosdoshmëria e ngritjes së një strukturë të posaçme kombëtare, me rol në procesin e miratimit të projekteve dhe në miratimin e lejes së shfrytëzimit të objekteve të përfunduara.
- Ndryshimet ligjore për realizimin e procesit për ngritjen e strukturës së kontrollit.

Aktorët përgjegjës:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Komisionet parlamentare